



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 23 dhjetor 2016, në mbledhjen e XXXI (tridhjetenjë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.10'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Shaban Osmani, Bahri Selimi, Mefail Rama, Radisav Perović dhe Xhafer Adem dhe Xhevdet Beselica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Bashkim Bajrami, Policia Kufitare, Skender Shatri dhe Bekim Karxhija, OSBE, Antal Farkas, KFOR.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, e përshëndeti dh i shprehu mirëseardhje Xhevdet Beselicës, pas kthimit nga Zvicra, ku kishte qëndruar një kohë për trajtim shëndetësor.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Komitetit për Komunitete më 5 dhjetor 2016

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Ngritja e Grupit punues për hartimin e Raportit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2016 dhe Programin e punës për vitin 2017

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Shaban Osmani, theksoi, të gjithë jemi në dijeni për punët dhe angazhimet e bëra gjatë vitit 2016 dhe shtoi, jam i bindur se e ndaj mendimin me të gjithë anëtarët e këtij Komiteti se jemi përpjekur t'i realizojmë përgjegjësitë ligjore të Komitetit për Komunitete, kemi mbajtur mbledhje të rregullta dhe kemi shqyrtuar çështje të shumta të cilat i përkasin komuniteteve.

Kemi bërë edhe vizita komuniteteve pakicë, e po ashtu i kemi vizituar të shkollat në të cilat mësimet i vijojnë nxënësit e komuniteteve RAE.

Këto i përmendi me qëllim që Grupi i cili do të hartojë propozimin e Raportit të punës për vitin 2016, t'i përmbledhë të gjitha çështjet dhe aktivitetet e ndërmarra në mënyrë që të paraqitet një pasqyrë sa më reale e punës së këtij Komiteti.

Gjithashtu me rëndësi është që edhe planifikimi i aktiviteteve për vitin 2017 të bëhet në mënyrë sa më detaje.

Pas propozimeve përkatësisht votimit u konstatua se për hartimin e propozimit të Raportit të punës për vitin 2016 dhe Programit të punës për vitin 2017, njëzëri u ngrit Komisioni në përbërje:

1. Shaban Ahmeti, kryesues
2. Shaban Osmani, anëtar dhe
3. Mefail Rama, anëtar

4. Të ndryshme

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, është mbledhja e fundit e vitit 2016 dhe e shfrytëzoi rastin me ju falënderuar për angazhimet dhe kontributin e dhënë në punën e këtij Komiteti.

Përndryshe jam i kënaqur me rezultatet e arritura, por nuk them se i kemi arritur të gjitha objektivat, në veçanti për disa çështje për të cilat është nevojitur buxhet, pra jemi angazhuar sipas mundësive që i kemi pasë.

Në fund të pranishmëve iu uroj festat e fund vitit.

Mbledhja përfundoi në orën 11.25'.

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01-006-92693
Podujevë,
23 dhjetor 2016**

**Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti**